

Procesverbal

Nga seanca e VI-të (gjashtë) e Kuvendit Komunal të Dragashit, e mbajtur më 28.06.2018, duke filluar në ora 10.00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit, nga seanca e kaluar e Kuvendit...
2. Shqyrtimi Kornizës Afatmesme Buxhetore 2019-2021 dhe miratimi i Vendimit për Diskutim Publik,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për dhënien afatshkurte në shfrytëzim të pronës në pronësi komunale,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për mbulesën e shpenzimeve të varrimit,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për lejimin e mjeteve për transport të nxënësëve,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për rimemërtimin e zonave të trafikut publik, dhe
7. Eventuale...

Seancën, me përshëndetje të pranishmëve... e hapi kryesuesi i KK-së z.Betim Merdiu, me kërkesën e deklaratimit të delegatëve, nëse ka vërejtje apo plotësime të rendit të ditës, të dërguar me ftesë...? Nëse jo, miratohet, njëzëri, rendi i ditës.

Pika e I-rë (parë) e rendit të ditës

Kryesuesi- Si zakonisht, fillimisht, kemi shqyrtimin dhe miratimin e Procesverbalit nga seanca e kaluar e Kuvendit, nëse ka vërejtje apo plotësime...?

z.Zinaida Elmazi- Unë lajmërohem lidhur me atë se, më herët, i kemi marr CD-të e s'di arsyen pse tani jo? E dyta-t'i kushtohet rëndësi më e madhe gabimeve gramatikore me rastin e diskutimit të delegatëve?

Kryetari- Ndoshta mund të ketë ndonjë gabim teknik, ndërsa lidhur me CD-të mendoj se ata janë të tepërt, pasi se këtu e kemi teleprezencën dhe "live" seancat që transmetohen në internet.

Kryesuesi- Nëse nuk ka vërejtje në Procesverbal, konstatoj se, njëzëri, miratuar Procesverbalin.

Pika e II-të (dytë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me pikën e II-të të radhës ku kemi shqyrtimin Kornizës Afatmesme Buxhetore 2019-2021 dhe miratimin e Vendimit për zbatimin e Diskutimit Publik dhe, siç keni mundur të vëreni, në këtë material, janë përfshirë çështjet themelore lidhur me këtë dokument zhvillimor të Komunës

deri në vitin 2021 dhe lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, fillimisht, fjalën e ka kryetari i Komunës z. Shaban Shabani, urdhëroni z. kryetar...

Kryetari-Zonja dhe zotri antare të Kuvendit të komunes dhe Ju pjesmarres. Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale është pjesë perberse e Kornizes Afatmesme të Shpenzimeve të R. Kosoves, Planit të Zhvillimit Ekonomik të Komunes dhe Prioriteteteve të komunes që janë edhe prioritetet e Qeverisë së R. Kosoves. Korniza afatmesme buxhetore, që po e prezentojmë, është një dokument i rëndësishëm i veçantë i cili miratohet në parim çdo vit nga asambleja komunale dhe vihet në diskutim publik deri në miratimin e buxhetit të komunes për periudhën e viteve 2019-2021. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat kryesorë për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Hartimi i Kornizes Afatmesme Buxhetore përbën një drejtim për institucionet buxhetore Komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2019/1 e lëshuar nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi. Buxheti për vitin 2019 për komunën e Dragashit në raport me vitin e kaluar planifikohet të jetë më tepër për 4%. Financimi nga Granti i përgjithshëm që është më tepër për 0.06% i arsimit është më tepër 8% dhe i shëndetësisë për 10%. Ndërsa të hyrat vetëneke planifikohen të jenë në shumë prej 500,817% që janë në kufirin normal të realizimit të tyre. Planifikimi i të hyrave vetanake për këtë periudhë buxhetore sipas Qarkores buxhetore 2019/1 është bërë nga Ministria e Financave me ndikimin e komunes për ta sjellë në suazat e mundshme të realizimit të tyre të mbështetura në tri vitet paraqitura.

Shumat e mjeteve të granteve duken kështu :

Granti i Përgjithshëm	4,089,125 euro
Granti i Shëndetësisë	1,019,910 euro
Granti i arsimit	2,702,139 euro
TV	500,817
Huamarrja	92,661
Totali	8,404,652

Granti i përgjithshëm është përcaktuar nga numrin e banorve resident të komunes. Numrin e komunitetit jo shumice dhe madhsise Gjeorrafike të komunes. Granti i arsimit është përcaktuar nga numri i nxenseve të kësaj komune. Ndërsa granti i shëndetësisë është përcaktuar sipas numrit të banorve dhe shërbimeve që ofron kjo qendër për vizita dhe shërbime tjera. Si pas Qarkores interne Buxhetit komunale 2019/1 dhe kornizës afatmesme buxhetore për vitin 2019 deri në nxjerrjen e Qarkores në vazhdim shuma e kategorive buxhetore për komunën e Dragashit janë planifikuar kështu: Paga 4,631,621 euro, mallra dhe shërbime 912,946 euro për shpenzime komunale 130,000 euro, subvencione 50,000 euro, ndërsa për shpenzime kapitale 2,680,085 euro. Shumat e parapara janë vlersim i gjendjes aktuale dhe ato mund të ndryshojnë deri me nxjerrjen e qarkores 2019/2 nga Ministria e Financave, ku si rrjedhim ndryshojnë edhe kategoritë buxhetore për vitin 2019. Në fund, Korniza buxhetore pas aprovimit vëhet në diskutim publik deri në aprovimin e buxhetit Shtator 2018 kur edhe miratohet buxheti i komunes për vitin 2019-2021. Plotsimet sugjerimet apo diskutimet eventuale shprej se do të jenë të mirseardhura dhe do të ndihmojnë procesin buxhetor në tërësi për vitet në vazhdim. Ju falemnderit.

z. Laurat Krasniqi- Unë e kam lexuar Kornizën dhe është e njëjta se ajo e vitit të kaluar e kopjuar? Ka disa ndryshime të cilat janë "kozmetike" e jo përmbajtësore. Kryetari i Komunës e theksoi zhvillimin e Komunës, por dihet mirë se zhvillimi shifet përmes zhvillimit të bujqësisë e këtu, të kategorisë e subvencioneve, për bujqësi, nuk është paraparë kurrfarë shumë e mjeteve. Në këtë sektor punojnë rreth 20 punëtorë që komunës i kushtojnë 115 mijë euro e që janë vetëm punëtorë byrokratik dhe nuk është se nuk kryejnë kurrfarë pune, por, për shkak të mungesës së subvencioneve, nuk po mund të vijnë në shprehje?! Realisht, ata mund të qëndrojnë nëpër zyre, por pa mjete nuk mund të bëjnë asgjë?! Sa u përket pikave që përmban ky dokument, unë do të flas për kategorinë e shërbimeve komunale, e që më 2017 ishin 130 mijë euro e kështu edhe më 2018 e duhet t'i kemi krahasimet, për të mos pasur suficit të mjeteve, pasi se në vitin 2017 kishim 120 mijë euro në suficit e për këtë kanë përgjegjësi zyrtarët kompetent dhe ju z.kryetar, e unë mendoj, se kjo kategori buxhetore, duhet të zvogëlohet. Në këtë mënyrë 15 mijë euro supozoj se do të shkonin në në suficit, sipas automatizmit? Këtë çështje duhet t'a kuptoni si sugjerim serioz, pasi se buxheti kërkon ndryshime të caktuara e sidomos të investimit kapitale e që, shumica e tyre, kanë të bëjnë me kubëzimin e rrugëve. Mendimi im është që të zvogëlohen investimet kapitale e që, një pjesë e buxhetit, të orjentohet në bujqësi, përmes subvencioneve nga ky Drejtorat, që sado-kudo, t'u ndihëmohet fermerëve tonë, për t'u nxitur kështu hapja e vendeve të reja të punës.

z. Zinaida Elmazi- Në Listën e shpenzimeve kapitale, për vitin 2019, për fshatin Krstec janë 20 mijë euro, por unë do të kërkoja që mjetet të ndahen si, për Kërsteci i Poshtëm dhe Kërsteci i Epërm, pasi se janë dy fshatra e investimet mos të shkojnë vetëm te njëri prej tyre?

z. Nexhat Isufi- Ne tani jemi në muajin qershor dhe para nesh e kemi buxhetin i cili do të shpërndahet në vitet vijuese dhe apeloj që të jemi sa më azhur dhe të shohim se cilat janë prioritetet e qytetarëve dhe, nëse janë themeluar këshillat e fshatrave, të bisedohet me ata se cilat i kanë prioritetet. Në fq.10, të të hyrat nga qiratë për vitin 2018 janë 29 mijë euro e në vitin 2019 planifikohen

40 mijë euro, unë parashtoj pyetjen si qëndron puna këtu? Pra, a është këtu fjala pës shtim të qirasë nga lokalet e Komunës apo pronave, apo kemi edhe lokale e prona tjera, që do të jepen me qira? Në bazë të informatave që kam, ne kemi persona që kanë me qira lokale të Komunës, por që nuk i paguajnë ato e që nga autori i këtij materiali kërkoj të na sqarohen këto dy shuma lidhur me qiratë? Sqarime dëshiroj edhe lidhur me fq.14 lidhur me shpërndarjen e mjeteve nëpër drejtorate...e pastaj përmenden edhe shërbimet publike e që duhet të jemi më aktiv kur është në pyetje higjiena e pastërtia të cilat i shfrytëzojmë ne dhe fëmijët tonë. Ka nevojë të hapen hapësira për rini me terrene sportive e që këtu fjalën të japin drejtoratet e shërbimet kompetente. Për këtë kërkoj sqarime se cila nga drejtorati përkatësi i ka shërbimet përkatëse, pasi se ne jemi përfaqësues të popullit dhe jemi kompetent të parashikojmë prioritete në këto lista. Sa i përket Blaçit, ku jam i interesuar dhe kam qenë i kyçur, te ne projekti më i madh është ai i ujësjellësit e 80 mijë eurot e parapara janë pak? Pse pak, nga se linja duhet të shpërndahet në 3 pjesë e me mjetet e parapara nuk mund të përfundon projekti i cili është punuar nga studenti i këtij fshati e që të jemi më të angazhuar reth realizimit të projekteve.

z.Velid Haxhisin- Tani e kemi KAB-e 2019-2021 e unë jam dëshmitar i disa Kornizave të tilla që i kanë miratuar kuvendet tona. Prandaj, lirisht mund të them, se bëhet për një shtim permanent të buxhetit tonë, meqenëse, më herët, kemi pasur buxhetin diku 4.5 milionë euro e tani e kemi fjalën për afro 8 milionë euro. Kjo flet për trendet pozitive të komunës sonë dhe shtetit për zhvillim. Kësaj Kornize i ka paraprirë analiza paraprake e kolegu theksoi se është kopjim, por që për mua është valide, por aty janë përvjedhur disa gabime teknike e që i kam vërejtur dhe theksuar edhe dje në KKomunitete e që nuk ishte askush për të na dhënë sqarime dhe këtë e lash për në Kuvend. Në fq.4, te pasusi i dytë, theksohet se 2-3 e bizneseve janë të kyçur në aktivitete komerciale, 5 % në sektorin e biznesit e 20% në zhvillim dhe prodhim, që, në tërësi, janë 25% e që për mua është një gabim i cili nuk duhet të qëndron në Kornizë. Më gëzon fakti se kemi shtim të subvencioneve, pasi se më herët ato ishin 24 mijë e tani parashihen 50 mijë euro e deri më 2021 planifikohet që, kjo shumë, të arrin në 70 mijë euro. Ndoshta, edhe kjo nuk mjafton, por është mirë që kemi shtim të tyre, nga se me vite është theksuar se nuk guxohet të ndryshohen pozicionet e që tani ia kemi arritur qëllimit. Mendoj se në planifikimet e ardhëshme, nga ato, të përfitojnë edhe DBujqësisë dhe ai i DKArsimit e të kemi edhe bursa për nxënës e studentë. Kemi Listën e investimeve të planifikuara për vitin 2019 e që, unë propozoj që, në të ardhën, bashkarisht, të kemi e dhe Listën e investimeve të realizuara. Këshu, prap, kemi blerjen e veturës pës DShëndetësisë e për cilën veturë është fjala? Ne, siç e dini, në shëndetësi kemi shumë nevoja e shumë nga to janë pa vetura, apo pa ato të ndihmës së shpejt, nga se, ndonjëherë, duhet prituri shoferin nga fshati fqinj. Sa u përket projekteve të planifikuara, këto lista, me siguri, do të pësojnë ndryshime, nga se janë projekte në të cilat dyshohet të janë sipas përkatësisë partiake e jo në bazë të kërkesave reale të qytetarëve?! Pra, planifikimi të jetë adekuat e mos të na ngjan që mjetet të shkojnë në suficit. Nëse DUrbanizmit do të bënte planin e investimeve në projekte kapitale do të ishte më lehtë, që pra duhet konsultuar me kohë për këto çështje dhe për këtë kërkoj prezencën më të madhe të qytetarëve nëpër tubime publike, që secili përfaqësues i fshatit të bënë listën e vetë të prioriteteve. Mjetet e parapara për projektin e QKomuniteteve në Restelicë, si projekt

dy vjeçar, mendoj se janë të mangëta e ne e kemi projektin ideor i cili kërko edhe një herë më shumë mjete, ndërsa e dini se ky projekt po zvarritet qe 7 vite, tani është projekt 2 vjeçar e që pra do të zgjat 10 vite dhe nuk mund të presim deri në plotësimin e qejfeve e tekeve të dikujt?! Ju e dini se Restelica është fshat i madh, me mbi 7 mijë banorë, e ne nuk kemi asnjë vend se ku mund të tubohemi për të përcaktuar prioritetet tona për vitet vijuese, për çka po jemi të detyruar të takohemi në kafene e që kjo nuk ka hije, për çka mendoj se këto pozicione duhet të pësojnë ndryshime të mëdha, deri në miratimin përfundimtar të Kornizës dhe Vendimit buxhetor.

z.Laurat Krasniqi- Një replikë të shkurtër e ajo ka të bëjë me atë se ne jemi dëshmitar se Komuna e Dragashit ka shtim të buxhetit, por që këtë buxhet nuk po e shfrytëzon populli, nëse mendoni se ka zhvillim e ne, faktikisht, po ballafaqohemi me migrim të popullatës?! Pra, migrimi është evident dhe njerëzit po laregohen nga komuna jonë, për shkak të mungesës së perspektivës e ky është realiteti. Prandaj, kur theksoni se nuk është kopjim ky dokument, shiqojeni pozicionin e investimeve kapitale, që kjo kategori është "copy-paste" dhe asgjë s'po ndryshohet dhe se asgjë s'po prodhohet, pos suficitit për të cilin jemi dëshmitarë?! Ajo që është alarmante, ne si përfaqësues të popullit këtë po duhet t'a shqyrtojmë dhe unë mendoj se komuna jonë nuk mund të zhvillohet, pa bujqësi. Ne e kemi DBujqësisë përmes së cilit, qe 20 vite, nuk është shpërndar diçka për subvencionim e për këtë kemi përgjegjësi dhe të ndajmë subvencione e bujqësia është në situatë që të ofron zgjidhje e perspektivë te ne.

z.Samidin Xheladini- Korniza Buxhetore është një obligim ligjor i cili duhet të kryhet në mënyrën që të planifikohen ajo se ku do të investimet në mënyrën që të zhgjidhen problemet e qytetarëve e që janë të mëdha e që duhet të angazhohemi të gjithë bashkarisht, duke përfshirë kryetarin dhe neve përfaqësuesëve të popullit, nga arsyeja e përkujdesjes sociale dhe mirëqenies së qytetarëve. Por, deri tani, mjerisht, një gjë e tillë nuk është bërë, nga se në këtë KAB, dhe më herët në plane, nuk kemi plane efektive të zhvillimit të Komunës sonë, siç nuk kemi edhe hapjen e vendeve të reja të punës dhe nuk parashihet zhvillim ekonomik e sidomos në lëmin e bujqësisë dhe energjisë e gjithçka tjetër çka ishte paraparë e premtuar gjatë fushatës zgjedhore. Pra, ne u kemi premtuar qytetarëve të gjitha, por asgjë nga ato premtime nuk kemi punuar?! E për këtë duhet të mendojmë seriozisht. Po ashtu, duhet të mendojmë seriozisht lidhur me furnizimin me ujë të të gjitha fshatrave, si dhe zgjidhjen e problemeve të ujërave të zeza dhe lidhur me mbeturinat, si atyre si hedhurina dhe atyre të ngurta me nevojën e ndërtimit të kolektorëve për ujëra të zeza dhe krijimin e mundësive për joshjen e e donatorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Siç po duket, në këtë KAB, prap, po dominojnë kubëzimet dhe po krijohet mundësia e madhe për keqpërdorim të parave publike. Siç ble në sy, bujqësia nuk është as në plan të dytë. Në pozicionin e kryetarit parashihen 130 mijë euro për subvencione, kurse për bujqësi nuk kemi asnjë propozim konkret? Në fq.4 janë paraparë pozicionet e komunës sonë e ajo që është shqetësuese, për shkak të pozicionit gjeografik, është komuna më e pazhvilluar dhe e lënë anash nga qendrat tjera. Ne, jemi dëshmitarë se tash më kemi filluar të lidhemi me pika kufitare e që ato po shfrytëzohen nga pjestarët e komunitetit jo shumicë e që duhet të

shfrytëzohen edhe nga të tjerët nga Komuna jonë. Në fq.5 është paraparë forcimi i ekonomisë nga Qeveria, pastaj përmendet bujqësia, gjendja sociale e qytetarëve e kjo arrihet me zhvillim ekonomik, kurse në Kornizë theksohet se përmendet ofrimi i shërbimeve komunale e që konstaton se në këtë drejtim nuk keni qenë efikas? Te fq.6 theksohet se Komuna nuk planifikon të hynë në obligime financiare e për këtë duhet anagazhim i eksperte për t'u parë se cilat dobësitë e cilat përparësisë e hyrjes në obligime të tilla. Ne nga e kaluara e dijmë se komuna e jonë nuk i ka shfrytëzuar sa duhet mjetet buxhetore, duke i shkuar ato në suficit e që dua të shpresoj se kjo nuk do të ngjanë në të ardhmen e, nëse ka nevojë të marrjes së obligimeve me kushte të volitshme, pse mos të aplikohet edhe kjo formë? . Në fq.9 theksohet mundësia e zvogëlimit të mjeteve vetanake, por pse kjo të ngjanë e mos të paguhen obligimet ndaj shtetit. Në fq.11 theksohet se do të ndryshohet forma e finansimit për arsimim të nxënësëve, sipas numrit, e kjo është mirë, por që një numër i mësuesëve po na rrezikohet. Po ashtu, po thkesoj se kryetari mirë e ka paraparë për veti shtimin e subvencioneve e ku do t'i shfrytëzoni ato më mirë e dini vetë? Te disa fshtra parashihen investime, flitet për projekte të përbashkëta e përmenden emrat, siç kemi rastin e lidhjes me rrugë rajonale.

z.Sefidin Mejzini- Në Listën e investimeve kapitale për vitin 2019 i cili ndërlidhet me vitet 2017 e 2018, këto investime janë shpërndar sipas aspiratave politike e që nuk është mirë e kjo praktikë duhet të lehet anash në të ashmën? Me sa e dij, mjetet e parapara nga Qeveria duhet të shpërndahen sipas numrit të banorëve e në disa fshatra kjo nuk ka ardhur në shprehje e që këto nuk janë mjete nga lobnimii partive politike, por mjete të përbashkëta e dihet se të gjithë fshatrat kanë nevojë për investime. Kërkoj një përgjigje, nga kryetari apo drejtorati i DKA-së, se vitin e kaluar për fshatin Kosovë janë paraparë 30 mijëe uro, që pas vendimit të kryetarit për moskubëzim të rrugëve që nuk janë publike, ajo shumë e mjeteve nuk është shfrytëzuar e kërkoj sqarim se çka me ato mjete? Po, ashtu, edhe tani për këtë fshat nuk janë paraparë investime, pos për shkollën e dihet se për shkollat është buxheti i posaçëm, kuse për fshtrat tjera është paparë shpërndarje e mjeteve, si për shkolla edhe për investime tjera e banorët e këtij fshati kanë nevojë për ujësjellës, kanalizime, mure mbrojtëse etj.

z.Selman Osmani- Dua të komentoj pak këtë buxhet pa u lëshuar në ata të mëhershmit, pasi se nuk ihsa në përbërjen e Kuvendit. Mendoj se buxheti i 2019 është buxhet gjithpërfshirës, edhe pse ka disa gabime teknike, që mund të evitohen me rastin e përpunimit të buxhetit. Sa u përket investimeve kapitale dhe Listës, unë do të përqendrohem në fshatrat e trevës së Gorës, ku nuk kemi të themluara këshillate fshatrave e që po ngjan që këto lista të përpilohen sipas përfaqësuesëve të partive politike. Unë do të theksoj vetëm një shembull në Krushevë, ku Këshilli i fshatit është themeluar anga ana e një grupi politikë dhe ai nuk funksionon qe 5 vitet e fundit?! Çka duhet bërë, pasi se nuk kemi informata reth këtij Këshilli të fshatit dhe investimeve që janë paraparë, siç nuk kemi informata as për investimet e bëra deri tash?! Psh. Kemi pasur sanimin e një ure në vendin e quajtur "Preko reke" ku punëkryesi është paraqitur në muajin Djetor dhe, në vend që t'a rregullon atë rrugë, e ka prishur fare. Kështu ka ngjarë edhe me ujësjellësin ku punët janë zhvilluar në Dhjetor?! Unë d t'i

lus delegatët që të shkrytëzojnë autoritetin tyre për t'u themeluar nëpër fshatra këshillat vendor, që nga ata të kemi informata të sakëta dhe cili është prioriteti i tyre. Ndërkaq, te Lista e investimeve kapitale kërkoj të bëhen ndryshime. Psh. Pika 17 thekson se asfaltimin e rrugës Krushevë-Zlipotok e në projekt janë paraparë 50 mijë euro e unë do të kisha lutur DDFinancave që këto mjete të ridestinohen në meremetimin e rrugës Krushevë-Globoçicë, pasi se atje gjendja është e rrezikshme, sepse ka rrëshqitje. E dyta- është sanimi i ujësjellësit të Krushevës e që nevoiten 25 mijë euro të cilat duhet kontrolluar gjatë realizimit të punimeve. Unë e përmenda vetëm Krushevën e problematikë e ngjajshme është edhe nëpër fshatra tjera, kurse, edhe një herë, kërkohet që Zyra e Komuniteteve në Krushevë të lirohet, që kërkoj nga autoritetet komunale në krye me kryetarin të përdorin e autoritetin e tyre për këtë lirim. Një grup politikë mban çelësat e asaj ndërtese e që nuk ka arsye që të ngjan diçka e tillë dhe të mbledhen njerëzit që, vërtetë, dëshirojnë të punojnë për të mirën e këtij lokaliteti e që në këtë mënyrë të grumbullohen njerëz për theksimin e problemeve reale e prioriteve e të hapet rruga për Listën e shëndoshë të investimeve kapitale.

z.Naser Myrtezani- Nëse thirrëmi në investimet nëpër fshatra, do të shohim se, janë përfshirë të gjitha fshatrat. Por, nëse flasim për fshatin Zaplluxhe reth asfaltimit të rrugës Zaplluxhe-Guri i Zi, kjo rrugë nuk është vetëm për Zaplluxhen, por ka karakter më të gjerë për rrugën kah Qendra Turistike atje e cila është, jo vetëm për të mirën e përgjithshme të fshatit, që sipas kësaj mund të konstatohet se për fshatin Zaplluxhe nuk është paraparë asgjë me projekte të vitit të ardhshëm?!

z.Hajrudin Hoxha- Unë do të ndalen te investimet kapitale ku janë paraparë hapa të qëlluar e unë, që 4 vite, po foli për sanimin e gurit në rrugës Globoçisë-Krushevë e tani po e shoh parashikimin e 70 mijë eurove, që është mirë, si dhe e përkrahi parafolësin zv.kryesuesin e Kuvendit z.Seljam O. Në diskutimet lidhur me sanimin e rrugës Krushevë-Restelicë e projekti i paraparë për asfaltim të rrugës Krushevë-Zlipotok prej 70 mijë eurove as që ka filluar e që, sipas inxhinierëve, për atë rrugë nevoiten edhe 50 mijë euro të tjera. Ne në Restelicë duhet të ndërtojmë rezervuarin i cili ende nuk është në funksionon për furnizim me ujë e për këtë mendoj se nesër, kur e kemi Takimin Publik, do të reagojnë edhe vetë qytetarët e Restelicës e ne është dashur të ndërlihem me projektet e pa realizuara me këto që parashihen tani e të shifet gjendja reale ku jemi. Në këtë drejtim dua të lëvdroj punëkryesin e kanalizimit në Restelicë i cili, vërtetë, po punohet sipas projektit dhe falënderoj DUrbanizmit dhe inxhinierin z.Sebahat Hasani, për çka qytetarët janë shprehur të kënaqur me projektin dhe punimet dhe të shpresojmë se do të kemi punime të mira edhe në të ardhmen. Më duhet të theksoj se projekti 2-vjeçar për Komuniteteve në Restelicë është i zgjatur, pasi se fshati më i madh-Restelica ka nevojë për atë për t'u mbajtur takime e ndryshme, përfshi këtu edhe angazhimin tonë në mbajtjen e njëzëve këtu, pasi se vazhdimisht po e lëshojnë terrenin tonë e të kemi projekte për bujqësi e blegëtori për të qëndrëruar këtu e jo që, edhe fshatrat tona, të shëndërrohen në kullota, në vitet e ardhshme?!

z.Rexhep Kamberi- Unë në mënyrë gjenerale jam i kënaqur me parashikimet dhe kam disa vërejtje. Por, meqenëse kemi kohë në deri në miratimin e parashikimeve, mund të korigjohen disa

gjëra të cilat i apostrofuam kolegët parafolës. Më vjen mirë që kryetari u tregua i ahpër, pasi se ekzistojnë zërat të cilat theksojnë se po tregohet kursimtar me buxhetin. Unë mendoj se projektet duhet të realizohen, për të mos ardhur në situata që mjetet t'i këthehen Qendrës. Ajo që nuk e theksua e që dua t'a di është se përmes kujt po planifikohet këto parashikime, pasi se unë si delegat i Vraniçit nuk jam konsultuar për asgjë? Në anën tjetër, as kryetari i fshatit nuk e din se çka do të parashihet për fshatin tonë?! Është mirë këtu DDUrbanizmit pasi se ai me propozime preferon kubëzimet e unë jam për kanalizimin dhe vendosjen e prronit në gypa e që për këtë nevojiten më shumë mjete se sa janë paraparë-15 mijë euro. Dikush nga delegatët përmendi mosdidefinimin e qartë të fshatrave e që mendoj se në pyetje ishin Kërsteci i Poshtëm dhe ai i Epërm e rastin kështu e kemi edhe me Rapçën e Epërme dhe Rapçën e Poshtme e, nëse flasim kështu, gjërat duhet t'i kemi të qarta, ne delegatët. Kam vërejtje në projektin e asfaltimit të rrugës Krushevë-Zlipotok e unë mendoj se, më me rëndësi është rruga Globoçicë-Restelicë se psh. ajo Globoçicë-Zlipotok. Kam edhe një vërejtje të ndërtimit i QKomuniteteve në Restelicë me plan 2-vjeçar me mjete 56 mijë euro e që mua më habit se si do t'i përfundojmë punimet, që pra ne do të kryjmë gjasmën e të vazhdojmë me gjysmën tjetër e kolegu theksoi se projekti zgjat qe 7 vite e tani do të fillohet?! Prandaj, do të ishte e rrugës që të parashihen 100 mijë e të përfundon prijekti e jo investuesi të punon gjysmën e punimeve! Edhe për sanimin e rrëshqitjes së gurëve mjaft folën parafolësit, e kjo po ngjan çdo vit. Mua më habit edhe një çështje reth arsimit të rinovimi i objekteve shkollore në Restelicë e Brod e që janë paraparë 4,5 mijë euro? Ne dijmë se Restelica e Brodi janë dy fshatrat më të mëdha të Gorës me numër më të madh të nxënësëve e me këtë shumë të paraparë nuk mund të sanohet as rrethoja e shkollave. Unë nuk e di këtu se për çfarë rinovimi është fjala, ndoshta e dijnë kolegët e Restelicës e, nëse ndahen mjetet përgjysmë, pra janë diku nga 2 mijë euro, që mendoj se për këto raste drejtorët e shkollave duhet të thonë fjalën e vetë. Megjithatë, të shpresojmë se me propozimet e dhëna për ndryshime, deri në Shtator, do të bëhen propozimet adekuate që të kënaqin shumicën, kurse delegatët në këtë drejtim dhet të bashkëpunojnë me këshillat e fshatrave, që mos të vijmë në situata që nga projektet e parelizuara mjetet t'i këthehen Qendrës.

z.Velid Haxhisin- Unë kërkova replikë e fjalën e mora tani. Me kolegun Laurat K. nuk desha të hyjnë në diskutim e po theksoj se proceset migruese të ne dhe në mbar Kosovën kanë filluar shumë më herët, qysh në kohën regjimeve represive kur ne kemi mundur vetëm të ëndërrojmë për këto mjete të investimeve, që pra migrimi s'është nga tani. Ne, si Komunë, jemi munduar t'i krijojmë kushtet më të mira të jetesës për qytetarët me infrastrukturën që e kemi bërë e t'a dini se para luftës kemi pasur mungesë të energjisë elektrike, rrugë të dobëta, mungesë të ujit të pijes e gjëra të tjera që kanë ndikuar në zhvillim dhe nxitjen e migrimit e që të dhe ne kolegët nuk po mund t'a frenojmë. Pra, migrimi është problem regjional e jo komunal. Pajtohem me atë se subvencionet duhet të janë më të mëdha se vitin e kaluar e të vazhdojnë me rritje edhe në të ardhmen e të bëhet ndarje adekuate e tyre. Pra, nuk kisha qëllimin të replikoj, por është e dukshme se ju po dëshironi të tregoni gjendjen se gjatë këtyre viteve nuk është punuar asgjë për krijimin e kushteve në të mira të jetesës.

z.Refik Latifi-Sa i përket buxhetit nuk do të ndalem shumë, pasi se kolegët-parafolës theksuar shumicën e çështjeve. Atë që kemi mundur të vërejmë është është çështja e bujqësisë dhe turizmit dhe ndarja e mjeteve nëpër fshatra. Pra, unë këtu po dëshiroj të ndalem në çështjen e kulturës, rinisë dhe sportit në Dragash. Unë pajtohem me shpërndarjen e buxhetit, por komuna ka dhënë kontributin në planifikim të sportit, por sa i përket kulturës mund të them se jeta kulturore është tejet e dobët, që mendoj se një pjesë e mjeteve duhet të ndahet edhe për këto çështje. Veçanarisht, mendoj se Komuna duhet të ndan buxhet për KF "Opoja" i cili është në gjendje të mjerueshme financiare e të parashikohen mjete për të mbijetuar ai tani, dhe nga vitin 2019. Këto mjete për këtë Klub të janë të karakterit të përkohësh, deri sa mos të gjendet mundësia e vetëfinancimit, sepse, në anën tjetër, investimet në ndërtimin e stadiumit nuk do të kanë efekt?!

z.Artan Loshaj- Pajtohem me diskutimet e parafolësive të cilët folën lidhur me veturën e DShëndetësisë e që këtë vit u ndan 40 mijë euro e që mendoj se me ato mjete mund të blehen 2 e jo një veturë, mjetet të ngelin për shëndetësisë e jo të na shkojnë në suficit. Po ashtu, lidhur me investimet kapitale për vitin 2019 nuk jam kundër investimeve dhe kubëzimeve, por me një vendim tuajin për (mos)kubëzim të parcelave private e ne në Rrenc, ku ka qenë tenderi, e kemi respektuar atë dhe kërkoj të kemi emrat e fshatrave se ku nuk po respektohet ai Vendim e jo të shkojnë për interesa të personave privat e që kërkoj të kontrollohet punëtorët përgjegjës, edhe pse e di se nuk jeni polic, por që duhet ndërmarr masa kundër punëtorëve të tillë. Reth kubëzimeve kemi afro 400 mijë euro dhe kam një vërejtje lidhur me fshatin Pllajnik e që, nga koha e ish-kryetarit, kubëzat ende qëndrojnë atje të pavendosura e këtë vit janë paraparë 15 mijë euro për atë fshat dhe 30 mijë që janë paraparë për vitin vijues të redistinohen në ndonjë projekt tjetër.

z.Samidin Xheladini- Nuk e di se ju dy kryetarët a keni bashkëpunuar, por ju jeni treguar të menqur që të shtoni shumën e mjeteve, duke e shtuar atë për 230 mijë euro. Pra, keni shtuar buxhetin e Zyrës tuaj për 60 mijë euro, kurse Zyra e Kuvendit është në të njejtin nivel të investimeve. Edhe një gjë më intereson, e ajo i përket Zyrës së Komuniteteve Lokale dhe Këthimit, e siç po shifet, në atë Zyrë kemi 46 mijë euro, dhe më intereson se çka bënë me ato mjete ajo dhe si i hargjon mjetet?!

z.Shpetim Hajredini- Të gjithë jetojmë këtu dhe e dijme rëndësinë e komunës sonë dhe të gjithë dëshirojnë që, brenda këtij 6-mujor të qeverisjes nga struktura e re komunale, të ndryshohet gjendja e që komuna jonë të jet-si Zvicërra, por kjo është e pamundur. Duke e pasur parasysh se buxheti i ynë është i limituar, unë nuk dëshiroj të jam kundër këtyre që po diskutojnë dhe është normale se, ju që jeni në opozitë kërkonit të kritikoni deri në maksimum, por në kuadër të kësaj periudhe të shkurtër nuk mund të realizohet e gjithë ajo që kërkohet. Dua të ndërlidhem rith planifikimit të buxhetit për vitin 2019 e, ju delegatët e vjetër sidomos, duhet të dini se ky nuk është buxhet definitiv, por vetëm planifikim. Sa u përket votave, ne ato i kemi kërkuar nga qytetarët dhe i kemi fituar dhe në bazë të tyre i kemi planifikuar projektet dhe kemi shkuar te kryetari dhe i kemi kërkuar ata që janë më të rëndësishëm për lokalitetet që i përkasim, si psh.unë konkretisht për fshatin

Kuk se cilët projekte do të realizohen e i kemi marr prasysh 2-3 projekte që qëndrojnë në buxhet dhe kështu kryhet puna.

Kryetari- Pa dyshim se diskutimet e sotme reth KAB-it e kanë rëndësinë e vetë. Ju e dini se reth kësaj jemi pajtuar se ky nuk është fundi i dokumentit, por propozim për KAB-in e sidomos ajo lidhur me Listën e investimeve kapitale e cila mund të pëson ndryshime. Dhe, nëse dëshironi të dini se kush ka prioritet në këtë, të dini se ju jeni ata të fundit të cilët miratoni buxhetin dhe Listën e investimeve kapitale. Ndoshta, ka qenë vështirë të evidentoj çdo diskutim për t'i dhënë përgjigje, por po vazhdoj me radhë... Njëri nga delegatët tha se KAB-i paraqet kopjen e atyre të mëparshëve dhe ka ngjajshmeri? Po, ka pasi se në pyetje është dokumenti i njejt, si dhe u pyetjet reth subvencioneve për DBujqësisë dhe për këtë po theksoj se ndoshta ka mundësi të planifikimit tjetër të buxhetit, por ne, në njëfar mënyre, duhet të mbajm funksionimin e shërbimeve tona, krahas investimeve kapitale edhe të shërbimeve komunale dhe ato janë të parapara për ato kategori e ato nuk mund t'i bartim në kategori tjera buxhetore. Ndërkaq, sa u përket subvencioneve, ne këtë vit, kemi partaparë bartjen e madje 50 mijë eurove, por që Ministria ka të drejtën që këto t'i zvogëlon si ato të vitit paraprak. Duhet këtu t'a keni parasysh se ne nuk jemi në gjendje t'i mbajm klubet futbollistike dhe fermerët e të tjerët, pasi se subvencionet janë ndihmë afatshkurte. Ju e dini se, sa u përket klubeve futbollistike po të ndaheshin nga 10 mijë euro, do të ngelin të pakryera projektet tjera. Pra, kriteret që përcaktohen për subvencione për t'u ndihmuar insitucioneve përcaktohen nga Ministria. Ndërkaq, sa i përket bujqësisë dhe përkrahjes fermerëve do të veprojmë, njejt sikurse në vitin e kaluar, duke u ndihmuar financiarisht e teknikisht përmes institucioneve ndërkombëtare, siç janë UNDP-ja apo "Helvetasi" e po të kishim ne si Komunë 100 mijë euro për subvencione gjendja do të ishte ndryshe për të përkrahur bujqit apo edhe studentët me bursa. Sa u përket konsultimeve me fshatrave, po theksoj se jemi në fazën e konsultimeve për themelimin e këshillave të fshatrave e për këtë OSCE-ja ka pasur një takim për t'u vendosur kontaktet me fshatrat, për të qenë sa më funksionale, nga arsyeja se këshillat e fshtrave nuk janë funksionale dhe për këtë kemi hendikep të madh në definimin e investimeve kapitale. Sa u përket të hyrave të Komunës, përmes inkasimit të mjeteve e që nga të hyrat e qirave të lokaleve janë 26 mijë euro e për vitin e ardhshëm parashohim 40 mijë euro sipas Planit të shërbimit të inkasimit dhe angazhimit më të madh. Duhet ditur se kemi raste të painkasuara të mjeteve nga lokalet që nga vitet e 80-ta? Sa u përket mjeteve për investime kapitale si psh.Blaçi me 80 mijë euro, kjo shumë është e pamjftueshme, por kemi paraparë që projektet të realizohen edhe me faza. Sa u përket investimeve të karakterizuara si politike, unë mendoj se nuk është ashtu, por është vështirë të ndahen mjetet në mënyrë të barabartë, pasi se, ndonjëherë, një fshat merr më shumë e ndonjëri më pak e kështu është vite me radhë. Unë, për vëdi, lirisht mund të them se nuk e kam shpërndarë buxhetin në baza politike. Po ashtu, edhe diskutanti i cili përmendi fshatin Zaplluxhe dhe ndërtimin e rrugës deri në Qendrën Turistike atje, mendoj se ka të drejtë e mund të ngjan që viteve tjera , për këtë, ky fshat të anashkalohet. Sa u përket subvencioneve, unë edhe më herët, theksova se ato lejohen nga Ministria e ne e japim propozimin. Kur u përmend blerja e automjtitet për Shëndetësi, nuk është në pyetje automjeti i ndihmës së shpejt, por ajo për nevojat e administratës së shëndetësisë

e sidmos për nevojat e QPSociale. Sa i përket QKomiteteve në Restelicë, ai projekt është 2-vjeçar e këto mjetet e parapara janë për fazën e parë e që duhet ndar mjetet pastaj, për realizimin e fazës së dytë dhe ju e dini se ne, edhe më herët, kemi paraparë mjetet për këtë Qendër, por që mjetet na kanë shkuar në suficit, për shkak të problemeve pronëso-ro-juridike. Dikush theksoi se buxheti nuk është në funksion të zhvillimit ekonomik e kjo është e vërtetë, nga se shpenzimet komunale dhe mirëmbajtjet janë shpenzime nga subvencionet. Sa i përket ujësjellësit qendror, ne kemi bërë analizat dhe vlerësimet e sërishme dhe në bazë të rekomandimeve të institucioneve të caktuara e që mendoj se do të përfundon ky ujsjellës famoz e që do të zgjidhej problemi i shumicës së fshatrave tona. Sa i përket kanalizimit të fshati Kuk, mund të them se as kompania e cila e ka përfunduar projektin nuk e merr obligimin e mirëmbajtjes së tij, pasi se situata atje është alarmante?! Ai projekt, vërtetë, ka kushtuar mjaft dhe 700-800 euro paguhet rryma për komore të cilat përdoren për pastrimin e ujërave të zeza, si dhe ka ngel problem çështja e punëtorit i cili ka qenë i punësuar aty e tani ka ngelur pa punë. Sa i përket vendkalimit kufitar në Krushevë-Shishtavec, nuk kemi kërkuar që në këtë vendkalim të kalojnë të gjithë qytetarët e komunave tjera për arsye sigurie, por s'ka probleme për kalim të qytetarëve të Komunës sonë, por që ky vendkalim do të jetë në tërësi funksional në të ardhmen. Sa u përket projekteve të caktuara me emrin e një fshati e që shfrytëzohen edhe nga fshatrat tjer, kjo është çështje problematike, por do të mundohemi t'i definojmë në maksimum sipas fshatrave për investime. Ndërkaq, lidhur me fshtin Kosavë, jam në dijeni se atë pjesë që e ka punuar kompania, ajo është paguar dhe pas vazhdimit të punimeve përsëri do të bëhet pagesa e të bëhet zgjidhja. Sa i përket Qendrës-Zyrës në Krushevë, ne mendoj se ata njerëz që kudesen për atë Qendër për nevojat dhe se nuk duhet të ketë dallime në shfrytëzim të sajë e që gjithësesi do të interesohej se si qëndron situata. Sa u përket ndryshimit të projekteve që i theksoi z. Rexhep K. ne pikërisht për këtë jemi këtu që të përcaktohen prioritetet dhe nuk është keqë që edhe ju si delegatë të bëni konsultime me fshatarët që në fund të vijne në shprehje projektet më adekuate dhe të nevojshëm. Sa u përket çështjeve të rrëshqitjes së gurëve në rrugën për Restelicë, vërtetë, është vështirë të bëhen intervenime pas intervenimeve, duke e pasur parasysh konfiguracionin terrenit dhe kushtet tjera të nevojshme për atë pjesë të rrugës, por është mirë që po tregohet gatishmëria e të gjitha shërbimeve për t'u bërë diçka. E problem tjetër shtesë se ajo rrugë nuk ka lidhje tjera alternative e që ngel nevoja e intervenimit me mjetet më të mëdha edhe përmes ministrive tona. Po ashtu, edhe çështjen e ujësjellësit e kemi evidentuar si ndër prioritet në Restelicë, ndërsa sa i përket kanalizimit atje ku po punohet atje, për herë të parë, e kemi delegatin që po lëvdëron punët e kryera. Po theksoj këtu nevojën që delegatët të bashkëpunojnë me përfaqësuesit e fshatrave për investime sa më të qëllura dhe adekuate. Te rinovimi i shkollës së Restelicës janë mjetet të parapara nga MASHT e nuk është çështje e cila ndërlidhet me propozimet tona dhënë kësaj Ministrisë. Sa i përket kulturës e sportit, ne e kemi shumë e paraparë prej 30 mijë eurove e që nuk mjaft për këtë sektor, por që sektori i këtill përkrahët edhe me forma tjera përmes aktiviteteve që zhvillohen. Këtë e bëjmë edhe përmes transportit të pjesëmarrësve në manifestime e gare, edhe pse nuk kemi mjetet të mjaftueshme për veprimtarinë e tërësishme të klubeve sportive nga subvencionet dhe ne nuk jemi në gjendje që, në tërësi, të

përkrahim aktivitetin e një klubi sportiv. Sa u përket shfrytëzimit të automjeteve zyrtare, unë mendoj se ato shfrytëzohen në mënyrë adekuatë e zyrtare dhe, sicili që i shfrytëzon ato për çështje private dhe i keqpërdor, e mban përgjegjësinë personale. Sa i përket fshatit Pllajnik dhe kubëzimeve atje, unë kam kontaktuar me përfaqësuesit e fshatit dhe kemi konstatuar se mjetet e parapara për ta nuk do të dështojnë dhe të shkojnë në suficit, edhe pse ka qenë e evidente çështja e mungesës së një sasive të kubëzave, por që mendoj se përfundimi do të jetë i mirë. Sa i përket diskutimit të z.Samidin Xh. reth subvencioneve nga Zyra e Kryetarit dhe te Zzra e Kuvendit, po theksoj se edhe ato nuk i menaxhon kryetari sipas qejfit të vetë. Parimisht, kërkoj nga delegatët që të miratohet kjo KAB-e, përkatësisht Vendimi për dërgimin e sajë në Diskutim Publik, deri në fund të muajit Shtator 2018.

z.Laurat Krasniqi- Më herët, kryetari, theksoi se kategoria e mallërave shërbimeve nuk mund të ndryshohet, por menjëher pas kësaj pike e kemi pikën që, ne si Kuvend, nga kjo kategori, duhet të ndajmë shumën e paraparë për transport të nxënësëve, që pa z.kryetar po vini në kontraditë me diskutimin tuaj?! Në vitin 2017 kemi pasur 32 mijë euro për shpenzime komunale, për zyrën e kryetarit dhe Kuvendit janë paraparë 72 mijë euro e që paraqet një shtim prej 125% e që paraqet shumë enorme. Unë mendoj se, ne si Kuvend, duhet të ndajmë një shumë të posaçme prej 10 mijë eurove për ndihëma studentëve e që do të ishte shumë në rregull t'i orjentohej DArimit, pasi se, në anën tjetër, kemi kategorinë e mllërave shërbimeve që po shkojnë në suficit? Unë jam i bindur se në këtë mënyrë nuk do të shkelim ligjin, pasi se jam konsultuar me profesionist nga kjo fushë e ju, me diskutimet tuaja, po vini në kontraditë në mes veti.

z.Samidin Xheladini- Te ne, si komunë specifike me dy komunitet, sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave e Përgjegjësiave proporcioni duhet të jetë 60% për komunitetin shumicë e 40% për komunitetin jo shumicë dhe, sipas shpërndarjes së deritashme të buxheteve, po na del se kemi të bëjmë me "diskriminim pozitiv", që pra po shkohet në dëm të komunitetit shumicë. Këtë mund ta shikoni nëse orjentohej në Listën e investimeve kapitale. Unë nuk jam kundër askujt e sidomos ndaj komunitetit jo shumicë, por kjo po bie në sy. Pas këtij finansimi në projekte, kemi edhe projekte tjera të dedikuara komunitetit jo shumicë, si dhe ato që arrijnë në formë të ndryshme edhe përmes Serbisë?! Neve nuk na pengon ndihëma e tillë që po shfrytëzon komunitet jo shumicë, por duhet të dihet dhe kjo dihet haptas, por kjo gjendje mos të implikohet negativisht në buxhetin tonë në përgjithësi e për këtë duhet biseduar seriozisht.

z.Valon Shabani-(DDEF) Desha të jap disa sqarime lidhur me mallërat e shërbimet dhe kryetari ka pasur plotësisht të drejtë t'a ndryshon këtë kategori, pasi se kategoria e transportit është nënkategori e shërbimeve. Për t'u kryer një projekt apo shërbim, ai shërbim duhet të ketë kodin e vetë personal. Pra, shpenzimet e udhëtimit, sipas sistemit informtaiv, janë kategori e mallërave e shërbimeve e këtu nuk ka kurrfar gabimi. Por, ajo që ne dëshirojmë të ndihëmojmë, sikurse fermerëve dhe studentëve, ajo formë e ndihmës mund të realizohet vetëm përmes subvencioneve dhe ashtu, siç janë subvencionet, nuk paraqet kurrfar gabimi dhe lidhur me këtë nuk kemi qëndruar duarkryq,

por kemi pasur disa takime në nivel qendror dhe sa kjo do të respektohet nga ana e MEF-it mbetet të shihet? Ne kemi kërkuar që subvencionet të shërndahen sipas numrit të banorëve dhe disa komuna në Kosovë kanë më shumë subvencione dhe mund t'u ndihëmojnë fermerëve dhe studentëve. Në mandatin e kaluar ZLFinanciar ka paraparë shumë prej 60 mijë eurove për subvencione, por ata që vendosin dhe bëjnë kufizime janë niveli qendror-MEF-i. Ajo që kemi bërë në emër të Drejtoratit është se nga pushteti qendror kemi kërkuar që të hyrat vetanake, që janë këthyer nga viti paraprak, të na lehen në dispozicion plër të vendosur ne, që të orjentohej aty ku e shofim më të arsyeshme. Po ashtu, kemi kërkuar që kategoria e mallërave shërbimeve dhe subvencioneve të janë në të njejtën kategori, në mënyrë që mjetete t'i orjentojmë aty ku më së shumeti kemi nevojë. Por, sa do të jetë kjo e mundur varet nga Ministria.

Kryesuesi- Kalojmë në votimi dhe kush është "për"-18, "kundër"-7 dhe të "përmbajtur"-0 vota, që pra miratohet materiali i kësaj pike.

Pika e III-të (tretë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën dhe në kuadër të kësaj pike tani e kemi shqyrtimin dhe miratimin e P/Vendimit për dhënin në shfrytëzim afatshkurtër të pronës në pronësi të Komunës dhe, prap, fjalën e ka kryetari i Komunës z. Shaban Shabani.

Kryetari- Siç shifet në material, në kuadër të kësaj pike kemi 4 propozime për dhënin me qira të pronës në pronësi të Komunës dhe, si rezultat i kësaj, kemi P/Vendimin e këtillë. Për këtë, shërbimet tona e kanë paraparë që dhënia e tyre të bëhet përmes Ankandit Publik, si dhe të bëhet përtrirja e kontratave me shfrytëzuesit e pronave komunale. Pra, në material qëndron se lokalet janë në pronësi të Komunës e, me këtë hap, qëllimi është shtimi i të hyrave të Komunës e dokumenti që e kemi në shqyrtim përshkruan atë pronë komunale, duke pasur parasysh se kontratat kanë skaduar dhe se nevojitet përtrirja e tyre, por përmes procedurave të Ankandit Publik që i parashe Ligji. Siç e dini, lidhur me këtë ne nga Kuvendi kemi të themeluar edhe Komisionin për shëniën e pronës komunale në shfrytëzim e, kësaj radhe, parashihet dhënia e saj me qira 5-vjeçare, por që Kuvendi mund të vendos edhe deri në 15 vite. Pas kësaj, pritet vlerësimi i legjshmërisë nga ana MAPL-së, që pastaj të ndërmerren masat e duhura nga ana e Komisionit të Kuvendit dhe organet përkatëse komunale.

z. Nexhat Isufi- Unë, jo rastësisht, në diskutimin tim të mëparshëm fola për lokalet me qira. Kuvendi e ka Rregulloren e vetë me të cilin parashihen obligimet dhe të drejtate delegatëve dhe, pikërisht te kjo pikë, është roli i delegatëve, pasi se ne jemi përgjegjës për dhënin e pronës komunale në shfrytëzim. Për të mos gabuar, ne duhet të miratojmë Vendimin në mënyrë më të mirë të mundëshme reth shfrytëzimit të pronës komunale, për të mos pasur kritika nga qytetarët. Deri më tani ishin paraparë të grumbullohen, nga kjo formë, 29 mijë euro e tani parashihet 40 mijë euro, që është mirë dhe unë kërkoja sqarim se a do të kemi pronë shtesë komunale, apo është e njejtja pronë në pyetje? Parashitroj pyetjen se si unë paguaj tatim në pronë e pse mos të paguhet pagesa e qirasë

në pronën komunale, kurse kam dësgjuar se, në emër të kësaj, obligimet janë me miliona të borgjeve të pa paguara e mdaje që nga vitet e 80-ta? Edhe përkundër kësaj, ne këtu nuk po e ngrisim zërin?! E kemi Komisionin e Kuvendit që ka përgjegjësi, por ai Komision nuk paguhet. Mendoj se duhet të medohet mirë se si unë psh. e kam marr në shfrytëzim e manaxhim parkingun komunal e nuk paguaj fare e që është koha e fundit që kjo praktikë të përfundon. Po ngjan që prap të konkurojnë të njejtit njerëz, duke gjetur lidhje me të njohur dhe autoritete të ndryshme dhe prap nuk po paguajnë?! Mendimi i im është që lidhur me këtë të kemi një Rregullore të posaçme dhe të qëndron pika se ata të cilët nuk paguajnë obligimet e deritashme, nuk kanë të drejtën e konkurimit për këto lokale. Unë jam i mendim se, nëse këtë e dëgjojnë qytetarët dhe ata që nuk paguajnë, do të jetë më ndryshe gjendja e disponimi. Pra, këto çështje duhet përmendur qartë në Ankand Publik, që secili t'i kryen obligimet para konkurimit.

z.Granit Rifaj- Unë, si kryetar i Komisionit Komunal për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, i përkrahi parafolësit që i paraqitën mendimet tyre. Por, dëshiroj të sqaroj se lidhur me këtë "se disa paskan lidhje dhe të njofshëm", po theksoj se të tillët që nuk i kryejnë obligimet nuk do të kanë të drejtën e konkurimit. Çmimi do të caktohet përmes Ankandit Publik dhe ai i cili do të ofron çmim më të lartë do të fiton Ankandin e në rastet të këtyllë, nuk nevojitet kurrfar lidhje. Ndërkaq, se si grumbullohet qiraja nga lokalet kjo është çështje tjetër dhe në kompetencë të organeve kompetente komunale që grumbullojnë të hyrat, Dhe, nëse e vlerësoni mirë punën e këtij Komisioni, do të ishte mirë që anëtarëve të tij t'u paguhen shpenzimet, pasi se, siç e dini, kemi anëtar që arrijnë edhe nga Prizreni, Kosava etj. Siç e dini, Komisioni ka të drejtën të rekomandoj sipas asaj që është konkruar për pronë komunale dhe kush i plotëson, më së miri kushet, për të lidhur pastaj Kontratë.

z.Samidin Xheladini- Të gjithë ne këtu kemi oligim ligjor e moral për këto çështe, që të mos gabojmë e puna të përfundon mirë. Ne e dimë se e kemi Komisionin apo Rregullore dhe nuk dyshojmë, por, në njëfar mënyre, po hezitojmë në miratimin e vendimeve të këtylla se si i kanë marrë dhe si paguajnë pronat komunale dhe duhet aplikuar ankande për lokale komunale. Në bazë të kësaj do të dihej gjendja me pronën komunale, sepse, në të kundërtën, ata që nuk kanë paguar do të vazhdojnë të mos paguajnë. Unë nuk jam shumë në dijeni, por po flitet se ato i shfrytëzojnë edhe ata me ndikim në Komunë e për këtë nevojiten sqarime e, me këtë, do të lehtësohej puna e Komisionit të cilin ne duhet t'a përkrahim e gjërat të saktësohen, që, pastaj, të lidhjen kontratave me shfrytëzuesit.

z.Laurat Krasniqi- Kur po flasim për këtë pikë, dëshiroj të theksoj se edhe lokalet e "Radio-Sharrit" e të tjerët atjer janë lokale komunale, përfshi këtu subjektet politike të cilat i kanë zyret e tyre e ne nuk kemi Rregullore për shfrytëzim të tyre. Në një mbledhje, kryetari ka theksuar se ato lokale janë uziurpuar nga ana e partive politike dhe si do t'i përcaktojmë rregullat ndaj qytetarëve, nëse vetë subjektet politike nuk i paguajnë ato?! Ato lokale që shfrytëzohen nga partitë politike atje nuk kanë kurrfar kontrata dhe kryetari nuk i ka çelësat e tyre, apo të ketë ndikim në to?! Pavarësisht se ato lokale a i shfrytëzojnë partit më të mëdha apo më të vogëla, ata janë pronë komuanle dhe nuk

jemi fare të informuar për mënyrën e shfrytëzimit të tyre nga partitë politike e kryetari na ka thënë se “nuk mund të bënë asgjë” lidhur me këto lokale?!

z.Velid Haxhisin- Unë pajtohem me këtë afat-5 vite që është paraparë me këtë P/Vendim, sepse kështu Komuna do të kishte çasje më shpesht se sa paguhet qiraje me rregul, e po të ishte afati 15-vjeçar ata do të akomodoreshin dhe se sa do t'i kryejnë obligimet do të ishte vështirë të dihet? Regullisht po kemi kërkesa për shfrytëzim të lokale në Dragash, por ne, lokale komunale, kemi edhe nëpër fshatra si lokale të karakterit të përkohshëm të cilëve kontrata u vazhdohej pa ankand. Në këtë mënyrë, kemi shfrytëzim të pautorizuar të pronave komunale dhe, paraktishi, paraqitet dikush të vendos diçka në pronën e Komunës, pa ndonjë procedurë të ankandit? Prandaj, unë do të tërheq vërejtjen që me këtë të merren më seriozisht inspektorët komunal e pastaj të mendohet për vazhdimet e kontratave?

z.Hajrudin Hoxha- Unë do të komentoj atë se afati i shfrytëzimit prej 5 viteve është i shkurtër, por që në kontrata të qëndron që “borgjet të paguhet e korigjohen brenda 6 muajëve”, që pra ne të jemi në dijeni për pagesën e pronës komunale. Disa nga delegatët kërkuar atë se kush paguan e kush nuk paguan qiranë lokalet komunale e ne fare nuk kemi pasur Raport të tillë, që pra duhet të jemi azhur për të miratuar vendime të drejta.

z.Vehbi Nazifi- Dëshiroj të thekoj se përkrahi punën e Komisionit që kemi themeluar të cilët punojnë pa pagesë. Siç e dini ekziston Ligji për Ankandet Publike i cili përcakton çmimin më të ulët dhe më të lartë e që do të ishte më së miil që, këto propozime t'i kenë në shqyrtim shërbimi dhe Komisioni të vazhdon me procedurat e Ankandit. Po ashtu, jam për atë që edhe partitë politike të konkurojnë lidhur me shfrytëzimin e lokaleve të tyre si zyre e të dihet sakt se nga cili subjekt shfrytëzohet ato lokale, qoft edhe me ndonjë shumë simbolike. Edhe një herë, kërkoj që këto propozime të miratohet e, për të tjerët, të vazhdojnë procedurat tjera vijuese.

Kryetari- Këtu është e qartë se për çka është fjala e ne e kemi paraparë që shfrytëzimi i përkohshëm të jetë 5 vjeçar dhe dhënia e lokaleve jepet nga arsyeja që të Komuna të ketë lëvërdi, që mendnoj se ky afat, vërtetë, paraqet afat të duhur e që pastaj të nënshkruhen kontratat, në mënyrë që të ofrohet mundësia e kontrollimit të këtyre lokaleve. Nëse dëshironi, mund të vendosni që lidhur me këtë, kohë pas kohe, të informohen delegatët e që ky proces i shfrytëzimit të pronës komunale të jetë funksional.

z.Sefidin Mejjini- Meqenëse unë jam delegat i këtij Komisioni Komunal, them se këta shfrytëzues kanë kontrata mbi shfrytëzimin me mundësi vazhdimi e duhet pasur kujdes? Ne kemi kërkuar sqarime nga zyrtarët ligjor se, nëse nuk u vazhdojmë shfrytëzimin, kanë mundësin edhe të na padisin dhe se ka shumë çështje të paharmonizuara me ligjet?

z.Artan Loshaj- Unë pajtohem me diskutimet e parafolësëve, por çka nëse konkurojnë edhe ata të cilët kanë qenë shkas i këtij Ankandi Publik? E dyta, kur theksohet afari 5-vjeçar, me mundësi

vazhdimi të Kontrartës, unë jam për këtë opsion, pasi se kjo është e mjaftueshme për shfrytëzuesin i cili paguan tatimin e kjo të merret parasysht me rastin e nënshkrimit të kontratave me ta. Pra, jam për ata që paguanë shfrytëzimin tatimin në pronë t'u vazhdohet kontratat e tjetëve t'u merret mundësia e shfrytëzimit e këtë guxim nuk e ka pasur ish-kryetari e nuk e di se pse?! Propozimi i im është se ai i cili paguan rregullisht, pse mos t'i vazhdohet Kontrata e të gjithë nga lokalet presin sezonin për të punuar diçka.

z.Granit Rifaj- Siç tha kolegu, këto lokale janë dhënë me mundësi vazhdimi e për këtë e kemi këtë P/Vendim e që pas 5 viteve, pavarësisht se a kanë punuar apo jo, kryetari ka duart e lira që të shpall prap Ankand Publik për to, si dhe të merret parasysht fakti se edhe nëpër fshatra kemi lokale komunale që shfrytëzohen e nuk paguajnë qira që apeloj që, rastet e këtilla, të paraqiten për t'u evidentuar sakt prona komunale.

z.Nexhat Isufi- Si duket të gjithë ne që diskutuam ishim në një linjë, por që kërojmë që veprojme sa më drejtë për t'u lehtësuar puna e Komisionit dhe të gjithë të biem përfundimin në frymën e diskutimeve tona. Ndërkaq, ekzekutivi i Komunës të na sjell Listën e lokaleve që shfrytëzohen, se kush janë shfrytëzuesit dhe a i janë përgjigjur pozitivisht pagesës së lokaleve sipas kontratave mbi shfrytëzimin, pasi se siç po del kemi lokale komunale edhe nëpër fshatra e që nuk paguajnë obligimet. Kemi lokale që shfrytëzohet, por që komuna mund t'i len në shfrytëzim të përkohshëm deri në atë moment nëse vendoset për ndërtim të diçkaja me interes të përgjithshëm shoqëror, pra atëherë edhe kontratat nuk vlejnë. Për këtë unë edhe kërkova Listën e lokaleve në shfrytëzim.

z.Velid Haxhisin- Kolegu Granit R. kërkoi qartë të thuhet se kush e shfrytëzon pronën komunale dhe se e unë e di se nëpër fshatra kemi shfrytëzim të pautorizuar të lokaleve komunale dhe pronave. Kemi rastin që në pronën komunale, madje në varreza, shfrytëzohet për lokal, madje qe 30 vite, pa u paraqitur si pronë e tillë apo aplikuar Ankandi?! Pra, nuk është problem shfrytëzimi i pronës komunale, për ata që janë pagues të rregullt, por për ata që nuk paguajnë dhe e shfrytëzojnë kondërligshëm. Konkretisht, në fshatin tim-Restelicë, objektet e tillë e pengojnë edhe trafikun dhe nuk ka hapësira për parkingje e ngjan që duhet prituri nga 3 orë për hyrje-dalje në fshat?!

z.Samidin Xheladini- Pse po ngurojmë të theksojmë e këtu-me stazh, kryetari është më i vjetri dhe parashtrahet pyetja se a kemi pasur raste që dikujt t'i prishet Kontrata për moskryerje të obligimeve komunale e, nëse kjo dihet, do t'i lehtësohej puna Komisionit. Ne si Kuvend, kërkojmë që të dihet secila pronë komunale e cila shfrytëzohet dhe se a i kanë kryer obligimet ligjore ndaj Komunës, sepse problemi qëndror se shfrytëzuesit e till po i shfrytëzojnë lokalet, por që nuk po i kryejnë obligimet ndaj tyre.

z.Rexhep Kamberi- Do të jem i shkurtër me kërkesë që organi kompetent komunal të na siell Listën e objekteve në dispozicion të Komunës, që të kemi njohurin se qysh janë dhënë në shfrytëzim

dhe jam për dhënë me qira të objekteve nga të cilët Komuna do të ketë lëvërdi. Sa i përket shfrytëzimit dhe kontratave, jam ithtar i asaj që, ata të cilët kryejnë obligimet ndaj Komunës, t'u vazhdoen kontratat e të tjerëve t'u prishen dhe mos t'u vazhdoen kontratat. Kolegu përmendi se nëse dikujt nuk i shkon biznesi dhe e mbyll apo çlajmëron lokalit, ai atë e mbyll, por t'i kryen obligimet ndaj Komunës. Në raset të tilla kontrata nuk vlen.

z.Vehbi Nazifi- Më vjen keq që po dal prap në foltore, por meqenëse po dikutojmë mjaft rreth kësaj çështjeje, të mbajmë një seancë të posaçme e që detalisht të merremi me te, për të miratuar vendim të vlefshëm. Dhe, nëse propozimi i Komisionit dhe kryetarit ka qenë që këtë P/Vendim t'a kemi në rend dite, të veprohet sipas rendit të ditës e për çështjet e lokaleve tjera të merremi veshe e të vendosim në seanca tjera. Pra, të përfundojmë me këtë pikë, dhe sipas P/Vendimit, që të lehtësohet puna dhe veprimi i mëtejshëm i Komisionit.

Kryesuesi- Propozoj të kalojmë në votim dhe kush është për miratimin e këtij P/Vendimi...? "për"-15, "kundër"-6 dhe "abstenim"-3 vota, që, pra, konstatoj, se e miratuam.

Pika e IV-të (katërtë) e rendit të ditës

Kalojmë në pikën e IV-të rendit të ditës-shqyrtimi dhe miratimi i P/Vendimit për mbulesën e shpenzimeve të varrimit, që, në njëfar mase, do të ndikonte pozitivisht në mbulesën e shpenzimeve ndaj familjarëve, siç kanë vepruar disa komuna tjera të Kosovës...

z.Artan Loshaj- Meqenëse ky ka qenë propozimi GP të PDK-së, e përkrahi propozimin e këtill dhe i përgëzoj ata që e kanë ndërmarr këtë hap, duke filluar nga kryetari dhe drejtoratet përkatëse. Dëshiroj që, ne si PDK, t'a përkrahim dhe e votojmë P/Vendimin që e kemi këtu.

z.Velid Haxhisin- Pasi se në propozim fjala është mjetet që duhet të kompenzohen nga buxheti i vitit 2018, kompenzimi të jetë nga janari 2018, nëse ka mjete dhe kërkoj nga kryesuesi që të qitet në votim. Nëse mjetet buxhetore janë të pamjaftueshme, shuma të zvogëlohet në 80 apo 90 euro, kurse për vitin 2019 do të kemi situatën e qartë-sipas numrit të vdekjeve?

z.Refik Latifi- Ne dijmë se shumica e komunave të Kosovës kanë miratuar vendime të këtilla dhe kjo edhe për qytetarët tonë paraqet mundësi të mirë, që mendoj se është lehtësim i mirë për qytetarët me rastin e vdekjes së anëtarit më të ngushtë të familjes. Ne, si GP i LDK-së dhe unë personalisht, mendoj se ky P/Vendim nga kryetari i komunës është i arsyeshëm, por që të na sqaron kryetari se si ka ardhur deri te ky P/Vendim dhe e ka bërë analiza paraprake apo statistika, apo ka biseduar me Këshillin Bashkësisë Islame?

z.Samidin Xheladini- Një iniciativë dhe kërkesë e këtill është elaboruar në mandatin e kaluar dhe të gjithë ne e kemi përkrahur iniciativën e këtillë, por që ka pasur mospërkrahje nga kryetari me arsyetim të mungesës të mjeteve buxhetore. Por, meqenëse kryetari aktual e ka paraparë, e

përkrahim këtë P/Vednimin i cili sidomos shkon në dobi të qytetarëve të cilët nuk kanë mundësi të mbulesës së shpenzimet që bëhen me rastet e varrimit dhe ky Vednim do të jetë i mirëseardhur për qytetarët.

z.Nexhat Isufi- Ne e dijme se kërkesa ka rrjedh nga viti i kaluar dhe në pyetje ka qenë dëshira, por edhe buxheti që kemi parapara nga viti i kaluar, por këtë mundësi nuk e kishte ish-kryetari vjet, dhe tani është mirë që e kemi mundësinë dhe t'a përkrahim këtë mundësi.

Kryetari- Ndoshta u desh që në fillim të marr fjalën dhe z.Refik L. dha sqarime të mira dhe, siç e dini, propozimi dhe iniciativa ka qenë e vitit të kaluar dhe KBIsleme ka lobuar që kjo çështje të jetë në rendin e ditës së Kuvendit, pasi se shumica e komunave të Kosovës tash më kanë përfunduar me këtë çështje. Ne, nga Kuvendi i klauar, kemi miratuan buxhetin me fondin oprej 30 mijë eurove dhe që tani vendimin e tillë, praktikisht, po e vejmë në realizim. Ne po e miratojmë Vendimin me mënyrat strikte të shfrytëzimit dhe se në bazë të statistikave të Shërbimit Civil dhe KBIsleme, te ne rastet e vdekjeve vjetore, sillen diku 360-400 raste për të cilat duhet llogaritur mjetet e në vitin tjetër duhet paraparë diku 60 mijë euro e për këtë është paraparë fillimi i pagesës për këtë nga muaji i 6-të i këtij viti. Mund të them lirisht edhe atë se, me këtë shumë, nuk mund të mbulojmë as për së afërmi të mbulojmë shpenzimet e varrimit, por, sado-pak, ato elementare i zbusim. Po ashtu, po theksoj se jemi në rjedha që me KBIsleme në Dragash, për këtë, të nënshkruajmë edhe një Memorandum dhe mënyrën e pagesë së këtyre mjeteve me dokumentet përkatëse, siç parashihet edhe në P/Vendim, së pos tjerash, të figuron edhe vërtetimi i KBIsleme dhe pagesa të fillon nga muaji i 6-të i këtij viti.

Kryesuesi- Pasi se nuk kemi diskutime tjera, kalojmë në miratimin e kësaj pike të rendit ë ditës dhe kush është "për"-24, "kundër" -0 dhe "të abstenuara" 1 votë (z.Velid H.), që pra miratohet ky P/Vendim.

Pika e V-të (pestë) e rendit të ditës

Në pikën e V-të kemi shqyrtimin dhe miratimin e P/Vendimit për mbulesën e shpenzimeve të transportit të nxënësëve...hapim diskutimet...?

z.Laurat Krasniqi- Çështja e parë që dëshiroj të di është se shuma prej 26 mijë eurove është e lartë për një distancë prej 19 km., që faktikisht po del se për 1 km. paguhet 5,5 euro dhe, me sa e di unë, nga f.Zaplluxhe për 40 km. të rrugës për në Prizren nxënësit paguajnë 1 euro. Pra, ky P/Vendim nuk ka kurrfar logjike, pasi se kjo është 12 herë më shumë se sa çmimi real i transportit në treg. Këtë e theksova si brengë, edhe pse dihet se "ngritja e dorës" këtu është bërë shprehi?!

Kryetari- Mund të ketë të drejtë parafolësi dhe ne kemi bërë konsultime lidhur me kontratat reth transportit të nxënësëve nga Dragashi për në fshatin Rrencë dhe ky paraqet problem të madh, pasi se, vërtetë, nuk po mund të gjenden operator që do të konkurronin për këto shërbime. Ne tash më e bëjmë kështu transportin e nxënësëve të fshatit Xerrxe e tani po dëshirojmë t'i integrojmë edhe

nxënësëit e fshtrave të Pllavës e Rrencit, Llopushnikut, që udhëtojnë me autobusin e Komunës Prandaj, në njëfar mënyre, kjo shumë mund të trajtohet e lartë, por nëse e merrni parasysht konfiguracionin e terrenit dhe intereset e ofertuesëve, na del se athua do të kemi fatin të angazhojmë dikend? Sidoqoft, ne duhet të sigurojmë mjete të mjaftueshme, që mos të dështojnë projektet për këtë. Tani kemi edhe fshatin Pllavë e që, më herët, janë transportuar me autobusin e Komunës i cili është amortizuar dhe nuk i plotëson kushtet për këtë lloj transporti. Na ka ngjarë që shoferi i ka pranuar udhëtarët dhe na ka lajmëruar se autobusi është prishur në rrugë gjatë dimërit e nxënësëit kanë ngelur shumë keqë?! Ne kemi menduar dhe kemi ardhur në përfundim se do të ishte shumë më mirë e më lirë të anazhojmë operator ekonomik për transport të nxënësëve, kurse edhe vërtjetet e nxënësëve do të ishin më të vogëla. Prandaj, kur operatori ekonomik të merr obligimet e transportit dhe do të përkujdeset edhe për nxemjen e nxënësëve gjat dimërit, nga se ne kemi nevojë që autobusët dhe disa automjete tjera t'i paraqesim për shitje me Ankand Publik, sepse janë vjetëruar. Pra, sa i përket kësaj çështjeje, ne mjetet i kemi dhe me këtë P/Vendim po dëshirojmë të funksionalizojmë transportin e sigurt të nxënësëve tanë.

z.Laurat Krasniqi- Ideja se është se kjo rrugë që është përshkruar në material, ne të jetë edhe 100 km. por që do të vazhdohet edhe viteve tjera e do të jetë presedan?! Sivjet po ndajmë 26 mijë euro e kështu do të vazhdohet edhe 4 viteve tjera, që do të thotë se, me 100 mijë euro, ne do të blinim autobus të ri apo kombi-bus për të transportuar nxënësëit? Z.kryetar, keni mjaft punëtorë që nuk punojnë e kështu do të angazhoheshin mjetet që të blehet autobusi i ri e që nga Pllajniku nxënësit do të arrinin me linjë urbane. Lidhur me këto çështje të udhëtimit, ndoshta, duhet të organizohen edhe debate publike me profesionist të fushës, për zgjidhje adekuate. Pra, më së miri, që ne si Komunë, të kemi paisjet tona se sa linjat t'u japim në menaxhim privat?

z.Samidin Xheladini- Ne (LDK) e përkrahim këtë P/Vendim e arsyeja kryesore është siguria e nxënësëve, pasi se fjala është për nxënës të klasëve të ulëta e në këtë mënyrë do të krijohet sigura, qoft edhe pak më shtrenjët. Nëse e marrim parasysht rastin se në mes të fshatrave Buzez-Bresanë kemi frekuencë të madhe të automjeteve e nxënësit e vegjël, ata, çdo ditë, janë nën rrezik potencial e që pra duhet të kemi qasje serioze me krijimin e kushteve për nxënës.

z.Artan Loshaj- Edhe unë e përkrahi këtë P/Vendim dhe kam disa pyetje për kryetarin e ajo kryesorja ka të bëjë me çmimin për 4,5 km. që është i lartë me 1,5 euro, por që e sqaroi me arsyet pse. Prandaj, pyes kryetarin se nxënësit a do të udhëtojnë me kombi-busa apo me autobus dhe, nëse po, a do të transportohen deri në fshat apo te ura në rrugën kryesore?. Ndërkaq lidhure me vërtjetet e kolegëve parafolës po theksoj se autobusi i komunës, shpesh-herë, është në prishje e nxënësëit kanë ngel në rrugë e, me këtë që propozohet, bëhet për të mirën e nxënësëve. Në rastet e defekteve është dashur të interevenohet me forma të ndryshme edhe me ndërhyrjen e kryetarit, por pa probleme e defekte, kurse edhe përmes kombi-busëve mund të dalin probleme e tani ai transport bëhet përmes 2 kombi-busëve të tillë.

Kryetari- DARSIMIT e ka analizuar këtë çështje dhe mendoj se transporti i nxënësve do të organizohet më së mirë që mundet dhe shpresoj se në këto ankande do të kemi ofertues, që është më mirë që kjo çështje të kryhet përmes tenderëve, pasi se do të konkurojnë firmat që i plotësojnë kushtet e që do të jetë më mirë dhe më e sigurt për nxënësit.

Kryesuesi- Kalojmë në votim dhe kush është "për"-22, 1 "kundër" (z.Laurat Krasniqi) dhe 0 "abstenime", që pra miratohet edhe ky P/Vendim...

Pika e VI-të (gjashtë) e rendit të ditës

Kryesuesi- Vazhdojmë me punën dhe lidhur me këtë pikë – P/Vendimin për riemërtimin e zonave të trafikut publik...: Ky P/Vendim është bërë sipas DURBANIZMIT-kompetent për këtë çështje e emrimet e riemërtimet bëhen nga Kuvendi, hapim diskutimet...?

Kryesuesi- Pasi se nuk kemi diskutime..., kush është për miratimin kësaj Kërkese...? "të gjithë", pra miratohet "unanimisht".

Pika e VII (shtatë) e rendit të ditës - "eventuale"...

Vazhdojmë me punën, urdhëroni, paraqituni në kadër të pikës së VII-të dhe të fundit – "eventuale"...

z.Samidin Xheladini- Kjo pikë - "eventuale" duhet të jetë gjithmonë në rend dite, pasi se këtu theksojmë problemet e qytetarëve tonë. Në Bresanë ka filluar projekti i kubëzimit të rrugëve, por qytetarët atje nuk kanë gypat e ujës-jellësit e që, në radhë të parë, kërkojnë vendosjen e tyre e pastaj kubëzimin. E dyta-largpërçuesi i cili gjendet pran xhamisë është gjithashtu mirë të rregullohet, por, në ndërkohë, me këtë u ndërprehen punët e qytetarët dëshirojnë të dijnë se ku qëndron problemi i këtij projekt? Për këtë, kërohet që punët të vazhdojnë. Po ashtu, dëshiroj të theksoj edhe çështjen e aftësisë të internetit në ZV në Bresanë e që ka nevojë për qytetarët dhe, nëse është problemi i natyrës teknike, ju kisha lutur që ajo të kuptohet me internetin e PTK-së?

z.Granit Rifaj- Diskutimi i im, fillimisht, ka të bëjë me çështjen e objektit të PTK-së në Beellobrad e cila qëndron e mbyllur, ndërsa me kërkesën e Këshillit të fshatit ka vazhduar të punon edhe 3 muaj, por që ajo do të mbyllet nga arsyeja se nuk po mund t'i përballojë shpenzimet të cilat krijohen. Objekti është i fshatit e punëtori që punon është nga Bresana dhe për këta qytetarë atje është kërkesa që, bashkarisht me organet komunale, të gjendet mundësia e funksionimit të mëtejshëm të këtij objekti postar, kurse po theksoj se ky është objekti i parë postar në Opojë dhe në çdo aspekt është i nevojshëm për qytetarët. Ne kemi biseduar me kryetarin e Komunës, nga i cili kemi marr përkrahje të caktuar, por nuk është e tepërt të bisedojnë të gjitha partitë politike që ky objekt mos të mbyllet? Po ashtu, dëshiroj të theksoj se se te rruga e vjetër në Beellobrad janë krijuar disa deponi ilegale, pasi se

e tërë Opoja po gjuan hedhurina, edhe pse disa herë ie kemi njoftuar Inspektionin. Nuk dëshiroj të akuzoj askend, por zgjidhje duhet gjetur?

z.Nexhat Isufi- Kam një pyetje për kryetarin, që, nëse ka mundësi, të më përgjigjet? Ajo ka të blëj me atë se a është në gjendje administata e Komunës, që në një seancë të radhës, të na dërgon regjistrin e lokaleve komunale dhe të pronës e cila është dhënë në shfrytëzim, si dhe ajo që nuk është dhënë? Ajo pronë e cila është dhënë në shfrytëzim, të dihet borgji, që Komisionit t'i ofrohet për veprim të mëtejshëm.

z.Zinaida Elmazi- Këtyre ditëve kam qenë dëshmitare e qytetarëve të cilët i kanë shprehur pakënaqësitë e tyre në llogari të firmës "Eko-Regjioni" dhe, më vjen mirë, që këtu është prezent kolegu ynë Nexhat I. i cili punon në atë firmë. Në këtu, në Kuvendin e mandatit të kaluar, kemi kërkuar që të gjitha familjet të kyçen në procesin e pagesës së mbeturinave dhe shumë fshatra u kyçën, por që shumica prej tyre tash më janë zhgënjyer me procesin e (mos)pastrimit të mbeturinave nga kjo firmë. Në shumë fshatra tona kemi deponi të ndryshme. Problemi i dytë është se çmimi me të cilin i barten mbeturinat-4,5 euro nuk është real e atë që mos të kanë kontejnerët dhe mbeturinat nuk po barten rregullisht. Tani ja se po arrijnë edhe kurbetçarët e turistë e mbeturinat duhet pastruar më shpesh. Për këtë, duhet të dihet se cilën ditë dhe kohë arrijnë kamioni. Çështje tjetër është se është jo reale për KEK-un, nëse qytetarët nuk përfillen me furnizim energjie. Pra, kërkoj që në seancën e radhës që këtë çështje t'a kemi në rend dite, për të mos ardhur në shprehje diskriminimi që bëhet. Ne jemi dëshmitar se sa mjete u janë shlyer atyre që nuk kanë paguar tatimin si dhe aty që nuk kanë paguar energji elektrike, që pra disa kanë përparësi e ata që janë pagues të rregullt po dëmtohen e diskriminohen. Nëse munden pensionsitet që jetojnë në Zvicërr... të paguajnë mbeturinat, të gjithë të kyçemi në këtë proces, edhe pse taksa prej 4,5 eurove është e lartë, për ata që jetojnë këtu e paguajnë për çdo muaj?

z.Velid Haxhisin- Edhe pse kryetari tani mungon, besoj se do të na jep përgjigje në seancën tjetër, në pyetjet që parashtrorj. E para-ende nuk e kemi marr Raportin e ZLKKthimit, edhe pse e kërkuam në seancën paraprake dhe KKomunitete. Pasi se shofim se Zyra hargjon mjete të caktuara, si për paga po ashtu edhe për mallëra e shërbime, si dhe kanë mjete të donatorëve të cilët veprojnë përmes kësaj Zyreje, e kërkoj nga kryetari atë Raport në seancën e radhës? Tjetra, kolegu G.R. e përmendi mbylljen e Postës, që unë do të them se lidhur me këtë çështje kemi reguar me vonesë, pasi se, më herët, është myllur posta në Krushevë e cila ka qenë në pronën në pronësi të Komunës e nuk ka pasur shpenzime të mëdha, por që është mbyllur?! Pyes kryetarin se a ka informata, se a jemi vetëm ne Komuna e Dragashit në shënjestër të krizës financiare të PTK-së si pasoj e manaxhimit të dobët, apo janë në pyetje edhe komunat tjera? Për këtë duhet të na jep sqarime - kryetari?

z.Naser Myrtezani- Kam disa kërkesa të qytetarëve e që, kryesisht, kanë të bëjnë me realizimin e investimeve nëpër lokalitetet tona. Unë, si delegat, kërkoj që investimet që realizohen të realizohen nga firmat e komunës sënë të cilat edhe paguajnë tatime për këtë? Kam edhe një kërkesë të banorëve

të Zaplluxhes të cilën e ka inicuar "Mahalla te Xhamia", që kërkon t'u ndërtohet rezervoari i ujit nga arsyeja, pasi se ky ekzistuesi nuk i plotëson nevojat? Po ashtu, kërkoj që rruga e cila qonë kah shkolla, konkretisht të udhëkryqi, të vendoset një tabelë e cila do të tregonte se aty gjendet shkolla e të vendosen edhe "policët e shtrirë", pasi se aty ka rrezik për qytetarët. Unë i kam lexuar edhe investimet nëpër shatrat tjera e që kanë edhe më shumë kërkesa se sa ceka unë. Konkretisht, unë si punëtor i arsimit kërkoj që në shkollën e Bresanës të orjentohej sa më shumë investime, pasi se aty janë dy objekte shkollore dhe shkolla mëe madhe fillore në Komunë. Po ashtu, kërkoj që të ndahen mjete për ndërtimin stadiumit të kësaj shkolle, duke u ndërtuar tribinat nga të cilat nxënësit do të përcillnin garat e turneve që organizohen, si dhe mbulesën e tribinave, kur kihet parasysh se stadiumi, pos për nxënësit, është i ndërtuar edhe për nevojatë rinisë së fshatit dhe më gjerë.

Z.Rexhep Kamberi- Unë do të ndërlidhem me ZLKKhimnit nga e cila kolegu Velid H. kërkoj Raport të Punës. Por, unë mendoj se kjo Zyrë duhet të jetë më shumë e konsultuar në realizimin e mjeteve investuese, në radhë të parë tek komuniteti jo shumicë e kjo mendoj se është në përshkrimin e punëve të tyre. Pasi se personeli kësaj Zyre qëndron mjaft në terren, mendoj se kanë shënime më të sakta se në cilin fshat çka ndërtohet e duhet të ndërtohet. Deri tani, një praktikë e këtill ka munguar e realizimi i mjeteve investuese ka shkuar përmes linjës kryetari-DUrbanizmit e në seancë sot po shifet se ka mjaft vërejtje reth realizimit dhe planifikimit të mjeteve nëpër fshatra e që duhet të kyçen edhe faktorët tjerë si:delegatë, përfaqësuesit e fshatrave dhe kjo Zyrë.

Kryetari- Po mundohet të përgjigjem në ato çështje për të cilat aerrita të marr shënime. Z.Samidin Xh. u interesuar për gypat e ujësjellësit në Bresanë për të cilët, deri në fillimin e punimeve, kemi menduar se janë funksionale, siç e dini, aty nevojitet një gyp prej 100 m. dhe hapja e kanalit dhe nuk është diçka që nuk mund të sigurohet e këtë do t'a shohim me operatorin e punimeve. Sa i përket largpërçuesit, është evidente se pengon, edhe pse dihet se kjo ka qenë me projekt të KEDS-it i cili duhet të vazhdon me kanale e që nuk janë kryer punët si duhet dhe janë ndërprerë, pasi se kam kërkuar vazhdimin e tyre jasht sezonit veror për mos t'u penguar qytetarët në punët e fushës. Sa i përket internetit në ZV në Bresanë kjo është çështje e kryer. Sa i përket postës, mjerisht, ajo po mbyllet e kjo është problem në nivel të Kosovës, pasi se posta është në nivel të palakmuershëm financiar, sepse, për shkak të shpenzimeve që po krijohen, po mbyllet objektet e postës. Ne jemi në dijeni për këtë procese, edhe pse nuk kemi ingerenca ne si Komunë dhe unë personalisht që të jemi përgjegjës për gjendjen. Sa u përket mbeturinave, i kemi identifikuar disa lokacione, por që po ka pengesa nga qytetarët që jetojnë në afërsi e që duhet menduar prap. Z.Nexhat I, pyeti lidhur me shënimet reth lokaleve në pronësi të Komunës, që është punë e madhe, por që nuk është keqë që kjo çështje të trajtohet edhe përmes Kuvendit. Reth pastërtisë, intenca jonë është që të kyçen të gjithë qytetarët në këtë sistem të pastrimit për t'u krijuar një ambient i pastërt. Për Raportin e ZLKKhimnit theksova se do t'a kemi në seancën e radhës dhe mund të them se nuk ekziston resor në Komunë i cili nuk tregon të hyrat dhe të dalurat materiale. E di atë se ka nevojë funksionimi i QKomuniteteve në Restelicë, kurse lidur me kompanitë punëkryese kjo nuk mund të realizohet për shkak të procedurave

tenderuese e ne këtë mundësi të veprojmë ndryshe nuk e kemi. "Mahalla Te Xhamia" në Zaplluxhe ka nevojë për ujë dhe për këtë jam njoftuar e që, vitin e ardhshëm, duhet ndërmarr diçka. Me DDUrbamnizimit kam biseduar për vendosjeje "policëve të shtrirë" te shkolla e Zaplluxhes, kurse dijmë se shkolla e Bresanës është ma madhja dhe ka më shumë nevoja për mirëmbajtje.

Kryesuesi- Meqenëse me Planin e Punës dhe aktivitetit të Kuvendit janë të parapara me buxhet mjetet për vizitë studimore, çka mendoni? Hapim diskutimin...

z.Laurat Krasniqi- Me sa e dij unë, delegatët nga Kuvendi i kaluar, janë paisur me "lap-topa" e që unë jam kundër, por, nëse ka pasur të drejtë, edhe unë do të isha që të më sigurohet ai e që ia kam premtuar një studenti e unë nuk jam për atë që ata pastaj të shiten?! Unë mendoj se vizitat studimore janë, vetëm e vetëm, për t'u shkuar në det, e për të shkuar në det, është lehtë e që mendoj se me taksa të qytetarëve nuk duhet shkuar në det?

z.Nexhat Isufi- Pasi se u hap çështja e vizitës së këtill, ato kanë qenë të organizura brenda dy viteve të mëparshme dhe çka është arritur me ato e dijmë ne që kemi qenë në ato e tani po flitet për detin? T'a dini se vizita studimore nuk bëhet 24 orë e që për qëndruar në një vizitë-komunës apo kuvendit duhet të jeni në termine e kohë të caktuara. Unë mendoj se ne, si delegatë, duhet të caktojmë terminin, kohën dhe mënyrën e që delegatët të përgatitetn për interevalin e caktuar dhe, ata që dëshirojnë të shkojnë-le të shkojnë, e unë kam mësuar mjaft nga vizitat e tilla dhe jam i mendimit që këtu të miratohet Vendimi, të shkohet apo jo në vizitë të tillë?

z.Samidin Xheladini- Sa u përket vizitave studimore unë kam qenë dhe jam kundër dhe unë dëshiroj që të jam në pushtet e partia ime (LDK) të fiton, por ja që nuk jam dhe jam që të dëgjohen propozimet e partisë sime politike e këtu vendos votimi me shumicë e kjo është demokraci e që pra vendos Kuvendi. Ne dijmë se si reafgojnë qytetarët lidhur me vizitat e këtilla e mendoj se ne po i hargojmë paratë e tyre e ky është opinioni , por që nuk është ashtu. Mua, edhe pse isha kundër, më ka këshilluar personi i cili i njëj gjërat duke më thënë se Vendimi i Kuvendit është obligativ edhe për ty, edhe pse isha kundër?! Këshu isha i dytruar të shkoj në vizitë. Edhe, nëse në Kuvend vendoset që të shkohet, unë do të isha kundër, jam i obliguar të shkoj e nuk kam qare?!

z.Vehbi Nazifi- Është mirë që u hap tema e vizitës studimore, që mendoj se ajo duhet të realizohet dhe të shëndërrohet në traditë, pasi se është e mirë për ne. Prandaj, t'a zgjedhim një Komision i cili do të vendos për kohën dhe vendin e realizimit të saj e jo të humbim kohë?

z.Nexhat Isufi- Unë kërkova që kryetari apo administrata e Komunës, se a janë të gatshëm të na ofrojnë Listën e lokaleve të Komunës, me qira. E dyta-lidhur me "lap-topat" unë, isha njeri nga ata që isha kundër e, kur ate e arritëm, isha ndër të parët që i morën ate. Prandaj, na pëlqyen apo jo disa vendime, ato janë obligative për ne. Unë isha kundër "lap-topavae", por nuk desha të shkeli vendimine shumicës dhe na, prap, këtu do të miratojmë Vendim dhe, nëse dikush do të vijë apo jo, me rëndësi është respektimi i Vendimit të Kuvendit tonë.

Kryetari- Mendoj se është e qartë, pasi se disa vendime që miraton Kuvendi i përkasin vetëm Kuvendit. Çështja e vizitës studimore është me Plan të Kuvendit dhe është çështje e Kuvendit se a do t'a realizon, apo jo? Nexhati ka të drejtë se atje nuk jeni 24 orë në vizitë dhe Kuvendi ka nevojë për një vizitë të tillë dhe se njerëzit nëpër vizita të tilla do të njoftohen më mirë, do të kanë ndonjë mbledhje me ndonjë kryetar të komunës dhe mund të merren idetë e tyre psh.lidhur me investimet. Pra, kjo është çështje e Kuvendit dhe ekzekutivi i Komunës duhet t'a realizon Propozimin. Po ashtu, edhe me "lap-topat", por, për ata të rinjë, apo për të gjithë delegatët? Këto vendime ju përkasin juve e neve na mbetet të sigurojmë mjete

z.Granit Rifaj- Mendoj se është pa nevojë të votojmë për propozimin e z.Nexhat I. pasi se ajo reth lokaleve është se janë dokumente publike dhe nuk ka nevojë të votohet.

z.Vehbi Nazifi- Lidhur me këtë propozim të z. Nexhat I., mendoj se kryesuesi duhet të merr obligim që këtë çështje-si pikë t'a paraqet, në ndonjerën, nga seancat e radhës?

z.Nexhat Isufi- Po, ajo Listë që e kërkoj të ketë emërin dhe mbiemrin e shfrytëzuesit të lokalit, vitin e dhënies, obligimet e kryera e shënime tjera?

Kryesuesi- Në rregull, kalojmë në votim të Vendimit për vizitën studimore dhe kush është "për"-10, 1 "kundër" dhe 3 vota "të përmbajtura", pra-shumica e të pranishëve dhe miratohet Vendimi i këtillë dhe, nëse nuk kemi diskutime të tjera, me këtë, përfundojmë seancën e sotme të Kuvendit. Ju felemderit dhe mirë u pafshim në seancën e radhës.

E përgatiti :

Shërbimi i Kuvendit Komunal

Kryesuesi :

Betim Merdiu



LISTA

E anëtarëve-delegatëve të Kuvendit Komunal Dragash
 Članova-delegata Skupštine Opštine Dragaš

Nr.seancës
 Br.sednice

VI-fc

Nr Br	Emri dhe mbiemri Ime i prezime	Subjekti politik Politički subjekat	Nënshkrimi Potpis
1	Betim Merdiu	PDK	<i>[Signature]</i>
2	Shpetim Hajredini	PDK	<i>[Signature]</i>
3	Xhemile Misinaj	PDK	<i>[Signature]</i>
4	Artan Loshaj	PDK	<i>[Signature]</i>
5	Vehbi Nazifi	PDK	<i>[Signature]</i>
6	Granit Rifaj	PDK	<i>[Signature]</i>
7	Suada Bajrami	PDK	<i>[Signature]</i>
8	Sevim Avdullahi	PDK	<i>[Signature]</i>
9	Elira Sulejmani-Krasniqi	PDK	<i>[Signature]</i>
10	Samidin Xheladini	LDK	<i>[Signature]</i>
11	Refik Latifi	LDK	<i>[Signature]</i>
12	Sefidin Mejjini	LDK	<i>[Signature]</i>
13	Naser Myrtezani	LDK	<i>[Signature]</i>
14	Arijeta Skeraj	LDK	<i>[Signature]</i>
15	Aida Misini-Halimi	LDK	<i>[Signature]</i>
16	Adelisa Krasniqi	LDK	<i>[Signature]</i>
17	Veljid Hadžisin	Vakat	<i>[Signature]</i>
18	Munir Jonuzi	Vakat	<i>[Signature]</i>
19	Zinalda Elmazi	Vakat	<i>[Signature]</i>
20	Seljman Osmani	JGP	<i>[Signature]</i>
21	Hatidža Šeh	JGP	<i>[Signature]</i>
22	Laurat Krasniqi	LVetëvendosje	<i>[Signature]</i>
23	Hajrudin Hodža	PGora	<i>[Signature]</i>
24	Nexhat Isufi	Nisma	<i>[Signature]</i>
25	Zaim Hajredini	AKR	<i>[Signature]</i>
26	Florent Rufati	AAK	<i>[Signature]</i>
27	Redžep Kamberi	GIG	<i>[Signature]</i>

Dragash dt. 28.06.2018

Proseduravajuel
[Signature]
